



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0536

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Vedat Poterqoi Kryetar i Panelit Shqyrtues, duke vendosur sipas ankesës së OE “MetBat SH.P.K.”, me seli në Drenas, kundër Njoftimit për Kontratë, dokumenteve të dosjes së tenderit, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Asgjësimi i mbetjeve medicinale dhe barnave me afat të skaduar” me numër të prokurimit 632-23-6728-2-2-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) Komuna e Gjakovës, më 04/09/2023, mori këtë:

Vendim

1. **Aprovohet**, si e bazuar ankesa e “MetBat” SH.P.K., me nr. 2023/0536, e datës 31/07/2023, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Asgjësimi i mbetjeve medicinale dhe barnave me afat të skaduar”, me numër të prokurimit 632-23-6728-2-2-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK)-Komuna e Gjakovës.
2. **Anulohet**, njoftimi për kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit “Asgjësimi i mbetjeve medicinale dhe barnave me afat të skaduar”, me numër të prokurimit 632-23-6728-2-2-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK)-Komuna e Gjakovës. Obligohet AK që të bëjë përmirësimet e nevojshme në dosjen e tenderit sipas arsyetimeve të dhëna nga eksperti shqyrtues.
3. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP-në për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën për mos respektim të vendimit, OSHP mund të ndërmarrë masa ndaj AK sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës.
4. Meqenëse ankesa e OE ankues aprovohet si e bazuar, bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.
5. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

Me 03.07.2023, Komuna e Gjakovës, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë. Me datën 20.07.2023 dhe me 26.07.2023, AK- Komuna e Gjakovës, ka publikuar Formularin për Korrigjimin e Gabimeve në Njoftimet e Publikuara. Hapja e ofertave ishte paraparë të bëhet me datë 08.08.2023, për aktivitetin e prokurimit “Asgjësimi i mbetjeve medicinale dhe barnave me afat të skaduar”, me numër të prokurimit 632-23-6728-2-2-1.

Me datë 24.07.2023, Operatori Ekonomik “MetBat” SH.P.K., ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim pranë AK- Komuna e Gjakovës dhe me datë 26.07.2023, Autoriteti Kontraktues, Komuna e Gjakovës, eka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me datën 31.07.2023, Operatori Ekonomik “MetBat” SH.P.K., ka parashtruar ankesë në OSHP-ë, me numër të protokollit 0536/2023, për aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: shërbim, vlera e parashikuar e kontratës: 10,000 €.

Ankesa e OE është ushtruar në pajtim me nenin 109.1, të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK çdo palë e interesuar mund të parashtrojë ankesë pranë OSHP. Meqë OE ka ushtruar po ashtu kërkesë për rishqyrtim, do të thotë se veprimet e të njëjtit i referohen po ashtu dhe nenit 108/A të Ligjit të cituar. Prandaj OSHP konsideron se ankesa i plotëson kushtet e parapara në kuptim të dispozitave tani më të cituara dhe e njëjta bie nën kompetencat e tij në kuptim të nenit 105, të LPP.

Palët janë njoftuar me raportin e ekspertizës me datë: 21 gushtë 2023. AK- Komuna e Gjakovës, ka deklaruar se nuk pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues, ndërkaq OE “MetBat” SH.P.K., ka deklaruar se pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues.

- Vlerësimi dhe administrimi i provave –

Bazuar në veprimet e përshkruara si më sipër, OSHP ka angazhuar ekspertin vlerësues në pajtim me nenin 111, paragrafi 5 të LPP, me detyrë që i njëjti në kuptim të nenit 113 të Ligjit të cituar, ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore, përkitazi me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër. Lidhur me këtë, me 21.08.2023, eksperti shqyrtues ka dorëzuar Raportin e vlerësimit me rekomandimet si në vijim:

- Ankesa OE “MetBat” SH.P.K., të aprovohet si e bazuar.
- AK të bëjë përmirësimet në dosje të tenderit dhe të zgjasë afatin për ofertim.

Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankues “MetBat” SH.P.K.

Eksperti shqyrtues sqaron se AK në dosjen e tenderit ka paraqitur disa kërkesa të përshtatshmërisë profesionale si më poshtë:

Operatori Ekonomik duhet të ketë licencë për grumbullimin dhe asgjësimin e mbetjeve mjekësore në përputhje me Ligjin për mbeturina 04/L -060 i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin 08/071.	Operatori Ekonomik duhet të ketë licencë për grumbullimin dhe asgjësimin e mbetjeve mjekësore në përputhje me Ligjin për mbeturina 04/L -060 i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin 08/071 – (kopje)
--	---

Sipas këtyre kërkesave, AK kërkon nga OE që marrin pjesë në këtë aktivitet prokurimi të dorëzojnë në ofertat e tyre edhe licencën për grumbullimin dhe asgjësimin e mbetjeve mjekësore në përputhje me Ligjin për mbeturina 04/L-060 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin 08/071.

OE “MetBat” kishte bërë kërkesë për rishqyrtim ku kishte kërkuar nga AK- Komuna e Gjakovës të bëjë përmirësim në Dosje të Tenderit që përveç Licencës të shtohet edhe Leja mjedisore e integruar. AK kishte aprovuar kërkesën për rishqyrtim si pjesërisht të bazuar dhe vendos të bëjë disa përmirësime si më poshtë:

IV.2.3) Teksti i cili duhet të përmirësohet/shtohet në njoftimin original (nëse aplikohet)		
Vendi i tekstit i cili duhet të modifikohet:	Në vend të:	Është :
Përshtatshmëria profesionale	Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me licence për	Operatori Ekonomik duhet të ketë licencë për grumbullimin

	menaxhimin e mbeturinave nga MMPH te jete valide Operatori Ekonomik duhet të jetë i pajisur me licence valide (kopje)	dhe asgjësimin e mbetjeve mjekësore në përputhje me Ligjin për mbeturina 04/L - 060 i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin 08/071 Operatori Ekonomik duhet të ketë licencë për grumbullimin dhe asgjësimin e mbetjeve mjekësore në përputhje me Ligjin për mbeturina 04/L - 060 i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin 08/071 – (kopje)
--	--	--

Pra ndryshimet në Dosje të Tenderit janë bërë duke u bërë zëvendësimi i përshtatshmërisë profesionale nga Licencë për menaxhim të mbeturinave në Licencë për grumbullimin dhe asgjësimin e mbetjeve mjekësore.

OE ankues pas këtij përmirësimi konsideron se nuk është marr parasysh kërkesa e tyre dhe AK nuk ka ndryshuar asgjë sipas kërkesës.

Duke u bazuar në LIGJI NR. 08/L-071 Për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.04/L-060 për Mbeturina, Neni 39, pika 1 dhe 2 thotë si më poshtë:

Neni 39

1.Titulli i kreut-VIII, të ligjit bazik, “Licenca për Menaxhimin e Mbeturinave”, zëvendësohet me titullin “Leja përkatëse Mjedisore”.

2. Titulli i nenit 55, të ligjit bazik, “Licenca për menaxhimin e mbeturinave” zëvendësohet me titullin “Leja Përkatese Mjedisore”.

3. Në nenin 55, të ligjit bazik, paragrafi 1, ndryshohet dhe plotësohet si në vijim: 1. Operatorët që menaxhojnë mbeturinat duhet të pajisen me leje përkatese mjedisore.

Pra siç mund të shihet edhe nga neni 39 i Ligjit për mbeturina i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin 08/071 titulli “Licencë për menaxhim të mbeturinave” është zëvendësuar me titullin “Leja përkatese mjedisore” por ky zëvendësim është bërë vetëm për kreun VIII të Ligjit bazik. Në anën tjetër sipas Udhëzimit Administrativ MMPH-Nr.10/2015 Për Trajtimin e Mbeturinave nga Produktet Medicinale, i cili vazhdon të mbetet në fuqi dhe përmes të cilit rregullohet më detajisht trajtimi i mbeturinave medicinale përkatesisht neni 15 i këtij udhëzuesi thotë kështu: *“Personat fizik dhe juridik të cilët kanë për qëllim trajtimin e mbeturinave nga produktet medicinale duhet të aplikojnë në MMPH për licencë”*. Po ashtu neni 49 i Ligjit bazik, pika 6 thotë se: “Ministria, në koordinim me Ministrin e Shëndetësisë dhe MBPZHR, nxjerr aktet nënligjore për menaxhimin e mbeturinave medicinale humane, respektivisht veterinarë”, siç është në këtë rast Udhëzimi Administrativ i përmendur më lartë.

Eksperti shqyrtues ka dërguar pyetje edhe drejt institucionit relevant përkatesisht Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës se për këtë aktivitet për mbeturinat mjekësore, MMPHI lëshon licencë apo leje mjedisore pasi që janë bërë disa ndryshime në Ligj, përgjigja e tyre ka qenë se: “Nuk mund të Licencohesh nga MMPHI për shkak se MMPHI nuk lëshon Licencë për menaxhim të mbeturinave. Sa i përket aplikimit për leje mjedisore, po gjithsesi që duhet të pajiseni, por para aplikimit për Leje Mjedisore ju fillimisht duhet të pajiseni me Pëlqim Mjedisor dhe në vendimin e pëlqimit mjedisor, mvarësisht prej kapacitetit të impiantit dhe karakteristikave tjera, definohet obligimi se a duhet të pajiseni me Lejen Mjedisore apo Lejen Mjedisore të Integruar.”

Duke u bazuar në këtë çfarë u sqarua më lartë, mendimi i ekspertit shqyrtues është se përderisa Udhëzimi administrativ 10/2015 që e shpjegon pikërisht trajtimin e mbeturinave medicinale i cili vazhdon ende të mbetet në fuqi, neni 15 kërkon që për këtë lloj të mbeturinave(medicinale) personat fizik/juridik duhet të pajisen me licencë, por ndryshimet në Ligji NR. 08/L-071 e zëvendësojnë titullin Licencë me Leje mjedisore si dhe fshihet paragrafi 1 i nenit 49 i Ligjit bazik- Personat që menaxhojnë mbeturinat nga produktet medicinale duhet të jenë të licencuar, atëherë vlerësojmë se tek kërkesat në Dosje të Tenderit përveç Licencës- ku ka ende OE të cilët kanë licencë me afat valid me të cilat janë pajisur para se të bëhen ndryshimet e Ligjit, duhet të shtohet edhe kriteri Leje mjedisore/Leje mjedisore e integruar por me qëllim që kjo leje të sqaroj qartë dhe specifikisht që është “Leje mjedisore për trajtimin/asgjësimin e barnave medicinale(mjekësore)” ose në leje të përfshihen kodet përkatese për trajtimin e mbeturinave medicinale dhe jo të jetë vetëm leje e përgjithshme mjedisore. Andaj nga ajo çfarë u tha më lartë vlerësojmë se pretendimi i ngritur nga OE ankues është i bazuar dhe konsiderojmë se AK duhet të bëjë ndryshimet në Dosje të Tenderit.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, AK të bëjë përmirësimet në dosje të tenderit dhe të zgjasë afatin për ofertim.

-Konstatimet e panelit shqyrtues-

Paneli Shqyrtues konstatoi se nuk ekzistojnë elementet për parandalim të konfliktit të interesit, siç kërkohet në kuptim të nenit 11 të Rregullores për Punën e OSHP, prandaj analizoi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe veprimet e palëve dhe konsideroi se nuk ka nevojë të konvokohet seanca publike me palë sepse ka prova të mjaftueshme për të vendosur sipas paragrafit 1, të nenit 24 të Rregullores së cituar. Paneli në këtë rast mori në konsideratë të gjitha pohimet ankimore, aktet dhe veprimet e AK dhe raportin e ekspertit.

Në fakt (natyrisht pavarësisht nga rekomandimet) Paneli vëren se procedura e prokurimit e cila është aplikuar në këtë rast është prezantuar në detaje në raportin e ekspertizës së ekspertit shqyrtues, duke i shpjeguar të gjitha fazat e procesit dhe veprimet e ndërmarra nga palët në kontekstin krahasues me aktet në fuqi, posaçërisht me Rregullat për Prokurim Publik.

Prandaj duke ju referuar nenit 104.1, të LPP, sipas të cilit kërkohet që procedura e shqyrtimit të zbatohet në mënyrë të shpejt, të ligjshme dhe efektive dhe duke i analizuar po ashtu në tërësinë e tyre shkresat e kësaj lënde në kontekstin e këtij procesi të prokurimit, Paneli nuk e konsideroi të nevojshme ta shtjelloj sërish në detaje dhe pa nevojë në këtë rast secilin pretendim ankimor, përderisa të njëjtat në mënyrë specifike janë veçuar sidomos në vendimin e atakuar të autoritetit kontraktues. Krahas tjerash, në vendimin e atakuar të autoritetit kontraktues dhe në raportin e ekspertit shqyrtues janë dhënë shpjegime lidhur me pohimet ankimore. Paneli vëren se arsyet e dhëna në raportin e ekspertizës janë profesionale dhe të argumentuara pa vërejtje me prova materiale, pa nevojë që të përshkruhen sërish. Prandaj Paneli mbështet shpjegimet e ekspertit shqyrtues i cili ka rekomanduar që AK të bëjë përmirësimet në dosje të tenderit dhe të zgjasë afatin për ofertim.

Paneli shqyrtues duke u bazuar në shkresat që i ka pasur në dispozicion, konstatimet e ekspertit shqyrtues vlerëson se për aktivitetin e prokurimit në fjalë dosja e tenderit nuk është përgatitur në pajtueshmëri të plot me nenin 7, 27 dhe 28 të LPP-së, andaj edhe vlerëson se Njoftimi për kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit “Asgjesimi i mbetjeve medicinale dhe barnave me afat te skaduar” me nr. të prokurimit: "632-23-6728-2-2- 1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KOMUNA E GJAKOVËS, duhet të anulohet, duke e obliguar AK që të bëjë përmirësimet e nevojshme në dosjen e tenderit sipas arsytimit të dhëna në raportin e ekspertizës, të cilat paneli i ka pranuar si të mirëqena dhe konform legjislacionit në fuqi.

-Përfundim –

Paneli shqyrtues ka konstatuar, se raporti i ekspertit shqyrtues përmban një vlerësim profesional dhe të argumentuar të pohimeve të ankuesit dhe të gjitha fakteve dhe rrethanave tjera të analizuar prandaj rekomandimet e dhëna janë miratuar edhe nga Paneli shqyrtues i OSHP-së.

Duke u bazuar në kompetencat e OSHP të rregulluara sipas nenit 105, lidhur me nenin 106 të LPP, Paneli Shqyrtues vuri në zbatim mes tjerash dhe nenin 103 të Ligjit të cituar sipas të cilit të gjitha palët e interesuara do të kenë qasje të barabartë në procedurat për shqyrtimin e prokurimit dhe në mjetet juridike dhe se, asnjë vendim i OSHP, nuk do të merret ose bëhet në mënyrën me të cilën diskriminohet në të mirë ose në dëm të një pjesëmarrësi në procedurë ose të një personi ose ndërmarrje tjetër. Prandaj nisur nga të lartcekurat Paneli Shqyrtues ka vendosur si në

dispozitiv të këtij vendimi.

Prandaj, bazuar shkurtimisht në të lartcekurat Paneli shqyrtues në pajtim me nenin 104 pika 1 dhe nenin 117 të LPP-së vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues
Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendi mi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KOMUNA E GJAKOVËS**
- **OE - MetBat SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: